Në bazë të kreut VI të Nenit 41 të Statutit të "Federatës së Gjimnastikës së Kosovës'' Bordi i FGJK-së, aprovoi këtë:

RREGULLERE DISIPLINORE E FGJK-së

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Çdo shkelje e statuteve, rregullave dhe rregulloreve, politikave dhe/ose procedurave, si dhe e parimeve të integritetit dhe drejtësisë sportive nga anëtarët e FGJK-së, shoqatat, klubet, gjimnastët, zyrtarët (gjyqtarët, trajnerët, stafi mjekësor ose të tjerë) i nënshtrohen sanksioneve të parashikuara nga Statuti dhe ky Kod i FGJK-së.

Këto parime shkelen nëse dikush:

- Të mos respektojnë statutet, rregullat, rregulloret, vendimet dhe direktivat e shkruara të FGJK-së,
- Shkel rregullat e Anti-Dopingut,
- Shkelja e normave të veglave gjimnastikore,
- Kryen çdo akt të korrupsioni aktiv ose pasiv ose tentativë për korrupsion aktiv ose pasiv,
- Të dëmtojë imazhin e gjimnastikës, FGJK-së ose anëtarëve të saj nëpërmjet sjelljes, fjalëve ose veprave të tij/saj,
- Të demonstrojnë sjellje antisportive,
- Shkelje të rëndë të udhëzimeve dhe direktivave verbale ose me shkrim të dhëna nga zyrtarët e FGJK-së,
- Të veprojë në mënyrë të tillë që të ndikojë në mënyrë jo të duhur në rrjedhën ose rezultatin e garave,
- Tregojnë gjykime të pakënaqshme dhe/ose të njëanshme në gara,
- Përdorimin e emrit të FGJK-së, fondet ose infrastrukturën e FGJK-së për qëllime të dëmshme për gjimnastikën,
- Sjellje në mënyrë ofenduese ndaj anëtarëve të FGJK-së, gjimnastëve ose zyrtarëve,

- Ngacmimi dhe/ose abuzomi me çdo person ose një grup personash, në çfarëdo mënyre, veçanërisht për shkak të racës, ngjyrës, seksit, orientimit seksual, gjuhës, fesë, opinioneve politike ose të tjera, origjinës kombëtare ose sociale, pronës, lindjes, paaftësia, atributet fizike ose aftësitë atletike ose statusi tjetër,

- Bie ndesh me ligjin e sportit dhe penal të Republikës së Kosovës,

- Të shkelë detyrimet e tij/saj kontraktuale ndaj FGJK-së.

Artikulli 1.

Me rregullat dispilinore, FGJK (në vazhdim Rregullore) përcaktohen detyrimet dhe përgjegjësit e të gjithë anëtarëve dhe shoqatave të FGJK-së, për përmbushjen e detyrimeve të përcakturara me Statut, rregullore, vendime dhe akte tjera, procedura disiplinore, masa disiplinore, mbrojtje të të drejtave dhe e drejta e ankësave kundër masës disiplinore të deklaruar.

Artikulli 2.

Dispozitat e Rregullorës vlejnë për të gjithë anëtarët e FGJK-së, organeve, gjimnastëve/eve, gjyqtarëve dhe punonjësëve tjerë të FGJK-së.

Artikulli 3.

Shkelja disiplinore është çdo shkelje e disiplinës sportive dhe sjelljes jashtë normave të përcaktuara nga Statuti i FGJK-së, aktet e përgjithshmë ose vendimet e trupit të FGJK-së.

Mosnjohja e Statutit aktual të FGJK-së, si dhe aktet tjera të dalura nga FGJK, nuk e justifikon dhe nuk e liron nga përgjegjesit askënd.

Artikulli 4.

Qëllimi i vendosjes së masave disiplinore është që të ketë një ndikim edukativ mbi shkelësit e standardeve sportive, për të parandaluar shkelësit nga kryerja e kundërvajtjeve, për të edukuar pjesëmarrësit e tjerë në sporte dhe për të ruajtu reputacionin e gjimnasikës në Kosovë,

Artikulli 5.

Asnjë masë disiplinore nuk mund ti shqiptohet askujt për shkelje disiplinore, nëse më parë nuk është cekur si shkelje e statutit, rregullave të anti-dopingut dhe rregulloret e FGJK.

II. PËRGJEGJËSIA DHE MASAT DISIPLINORE

Artikulli 6.

Për shkak të mos përmbushjes dhe kryerjes së pakujdesshme të detyrimeve të marra në bazë të kushteve të parashikuara me ligj, statut, aktet e përgjithshme dhe vendimet, anëtari ose anëtarët e FGJK-së përgjigjën moralisht dhe materialisht, varësisht nga vepra e kryer.

Artikulli 7.

Para përcaktimit të masës disiplinore, për bazë merren, pasojat dhe rëndesa (natyra) e shkeljes së kryer disiplinore, rrethanat dhe mënyra se si ka ardhë deri të kjo shkelje, sjellja para dhe pas shkeljes, iniciativa e shkelësit në momentin e veprës, dhe rrethanat tjera lehtësuese dhe rënduese.

Nëse vërtetohen rrethanat e veçanta të lehtësimit, shkelësit mundet ti shqiptohet edhe masa e butë disiplinore, nga ajo vepër e parashikuar për shkelje.

Kjo masë disiplinore vlenë edhe në raste kur shkelësit janë Junior/e ose Pionier/re.

Artikulli 8.

Masat disiplinore mund ti shqiptohen apo vendosen ndaj garuesve dhe përsonave të tjerë përgjegjës brenda FGJK-së.

Pjesëtarët përgjegjës janë, mejku i ekipit, delegatët gjyqtarët, trainerët, pjesëtarët që kanë për bazë udhëheqjen apo menaxhimin e klubit, autoritetet garuese, dhe ata që e kryen detyra të veçanta gjatë garave etj.

Përsonat përgjegjës, që janë jashtë konkurrencë, janë të gjithë anëtarët e trupit drejtues të FGJK-së, të gjithë anëtarët e trupit drejtues të shoqatave të gjimnastikës si dhe anëtarët e tjerë.

Artikulli 9.

Për të gjitha shkeljet disiplinore të kryera nga garuesit ose përsonat përgjegjës të federatës ose jashtë saj, mund të vendoset masa disiplinore edhe ndaj atyre klubeve apo shoqatave të cilat mund të jenë objekt konkurrues ose personit përgjegjës kujt i përkasin.

Artikulli 10.

Për shkeljet e parapara me këtë rregullore, mund të shqiptohen këto masa disiplinore:

1. Për Garuesit,

- Vërejtje, Vëretje Publike,

- Përjashtim nga pjesëmarrja në numër të caktuar të garave, në një kohë jo më të shkurt se 1 muaj, dhe jo më shumë se 12 muaj.

- Përjashtim nga të gjitha aktivetetet në një kohe prej 2 muajve, mirëpo jo më gjatë se 12 muaj,

- Përjashtim nga pjesëmarrja në nivel nacional nga 1 muaj deri në 12 muaj.

2. Për përsona përgjegjës:

- Vërejetje – Vërejtje Publike,

- Ndalim për kryerjen e detyrava të veçanta për nje periudhë të kufizuar kohore prej jo më pak se 3 muaj, dhe jo më shumë se 2 vjet,

- Ndalim nga të gjitha detyrat në një kohë të caktuar jo më pak se 6 muaj, dhe jo më shumë së 2 vjet.

3.Për klubet dhe shoqatat:

- Vërejetje – Vërejtje Publike,

- Ndalim i aktiviteteve në një sallë ose vend tjetër prej 1 muaj deri ne 2 vite,

- Ndalim pjesëmarrje në gara, në një kohë të caktuar prej më së shumti 6 gara, gjegjësisht më së shumti 6 muaj.

- Ndalim pjesëmarrjë në të gjitha aktivitet, në një kohë të caktuar më së shumti 12 muaj.

Artikulli 11.

Shkeljet disiplinore të garuesve janë:

- Sjellja para, gjatë dhe pas garës të cilat nuk janë në përputhje me normat normale dhe morale të kodit etik të FGJK-së, dhe sportit, propozimet për organizimin e garave, dhe dispozitat e ketij manuali të rregulloreve disiplonore dhe çdo lloj sjellje tjetër që mund të dëmtoj reputacioni apo imazhin e FGJK-së.

- Mosprezenca apo mospjesëmarrja në gara, pa ndonjë arsye të veçant, ose përgaditjet nacionale reprezentuese, ku paraprakisht është / janë njoftuar dhe zgjedhur nga ana e udhëheqësit kombëtar (reprezentuesi) i FGJK-së.

- Refuzim për të marrë pjesë në ekipin reprezentues nacional, të cilës do kategori,

- Pjesëmarrja duke i anashkaluar apo mos u përshtatur me kodin dhe rregullat e veshjes sportive,

- Pjesëmarrje në garë përderisa në fuqi është ndalesa e pjesëmarrjes ose suspendimi ose deri sa nuk është i/e regjistruar.

- Pjesëmarrje pa librezë, pa liçnecë për të cilin/cilën nuk është bërë regjistrimi më kohë nga ana e klubit, si dhe pjesëmarrja në ngjarje sportive ndërkombëtare pa pëlqimin e FGJK-së.

- Shpifje dhe ofendime të klubit/ve, shoqata/ve dhe anëtarëve të tyre, si dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë garues apo përgjegjës që janë të përmendura në artikullin 8. të kesaj rregullore.

- Mosprezenca deri në fund të garës pasi që gara ka filluar, përveç rasteve kur është vërtetuar se braktisja e garës është si pasoj e ndonjë smundje, lëndimi ose ndonjë anomali tjetër.

- Mbushja e aplikacioneve (librezave) me të dhëna të pasakta për regjistrim dhe akte tjera zyrtare.

- Duke mos u përgjigjur në thirrjen e komisionit disiplinor gjatë zhvillimit të procedurave disiplinore, si dhe dhënjes së deklaratave me shkrim ose në mënyrë verbale të pavertëta, me qëllim të devijimit apo shmangëjes së të vërtetës.

Artikulli 12.

Masat Disiplinore të përsonave përgjegjës janë:

- Mos zbatimi i Statutit dhe rregullave, rregulloreve të FGJK-së,

- Mos arritja në kohë (vonesa) në ndonjë garë, në të cilën ai/ajo është emruar zyrtarisht, si gjyqtarë, trainer, ose ndonjë përson tjetër përgjegjës.

- Sjellje joadekuate sportive ndaj sportistëve që mund ta dëmtojnë reputacionin dhe imazhin e FGJK-së.

- Ngacmimi dhe/ose abuzimi me çdo person ose një grup personash, në çfarëdo mënyre, veçanërisht për shkak të racës, ngjyrës, seksit, orientimit seksual, gjuhës, fesë, opinioneve politike ose të tjera, origjinës kombëtare ose sociale, pronës, lindjes, paaftësia, atributet fizike ose aftësitë atletike ose statusi tjetër,

- Pjesëmarrja duke i anashkaluar apo mos u përshtatur me kodin dhe rregullat e veshjes sportive sportive,

- Shpifje dhe ofendime të klubit/ve, shoqata/ve dhe anëtarëve të tyre, si dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë garues apo përgjegjës që janë të përmendura në artikullin 8. të kesaj rregullore.

- Keqpërdorimi i pozitës zyrtare, përdorimi i paautorizuar i shpenzimve financiare, tejkalimi i autoritetit zyrtar dhe mbajtja e aseteve të FGJK-së, dhe mos-parandalimi i tyre.

- Mos paraqitja e rezultateve për një kohë të gjatë të garave apo aktiveteteve tjera pa asnjë arsye.

- Duke mos u përgjigjur në thirrjen e komisionit disiplinor gjatë zhvillimit të procedurave disiplinore, si dhe dhënjes së deklaratave me shkrim ose në mënyrë verbale të pavertëta, me qëllim të devijimit apo shmangëjes së të vërtetës,

- Pjesëmarrja në ndonjë garë, ose ngjarje që është e ndaluar nga organi kompetent i FGJK-së, respektivisht pjesëmarrje personale, ose largim nga pjesëmarrja e ndonjë aktiviteti ndërkombëtar, pa pëlqimin e FGJK-së.

- Pjesëmarrja në gara ndërkombëtare si klubi pa i njoftuar autoritetet e FGJK-së me shkrim, si dhe pjesëmarrja në gara ndërkombëtare pa u prezentuar simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës.

Artikulli 13.

Shkelje e rëndë disiplinore, e garuesit dhe përsonave përgjegjës është kërcënimi, përpjekja dhe përdorimi i forcës fizike ndaj garuesit tjetër (garuesve tjerë), përsonave përgjegjës dhe shikuesve, ngacmimi dhe/ose abuzimi, psikologjik, seksual, sjellje e pahijshme fizike, ndaj sportistëve dhe anëtarëve tjerë.

Artikulli 14.

Shkeljet disiplinore të shoqatave janë:

- Mosprezenca e pajustifikuar në një garë (aktivitet) në të cilën shoqata është zotuar të kryej.

- Dështimi i sigurimit të kushteve për të zhvilluar një aktivitet apo garë në përputhje me rregullat e aplikueshme të FGJK-së, të cilat kushte si nokoqir duhet ti sigurojnë.

- Mos pagesa e anëtarësisë, kotizimit, regjistrimit dhe detyrimet tjera monetare të parashikuara nga Statuti, Rregullat dhe propozimet.

- Verifikimin e të dhënave të pasakta.

- Mundësimin e pjesëmarrjes së garuesve të paregjistruar, të shkelësve dhe të suspenduarave.

- Mos përmbushjes së detyrave ndaj FGJK-së, të cilat janë të parapara me akte të FGJK-së, gjegjësisht vendimeve të trupit FGJK-së.

- Sjellja e garuesvë, përsonave përgjegjës dhe shoqatave në vend dhe jashtë vendit të cilat sjellje mund të prishin imazhin dhe reputacionin e FGJK-së, dhe sportin e gjimnastikës.

- Mos lejimin ose anashkalimin e garuesit dhe trajnerit të shkojë në trajnime ose gara kombëtare dhe ndërkombëtare të ndryshme.

- Pjesëmarrje në garat osë ngjarjet ndërkombëtare, organizime të ngjarjeve të tilla pa miratimin paraprak të FGJK-së.

III. KOMISIONI DISIPLINOR, FILLIMI DHE MBARËVAJTJA E PROCESIT

Artikulli 15.

Duke u bazuar në këtë Rregullore disiplinore, Bordi Disiplinor i FGJK-së, i nënshtrohet procedurave disiplinore dhe vendosjes së masave disiplinore.

Bordi disiplinor përmban në vete Kryetarin dhe dy anëtarë, dhe dy anëtarë alternative (rezervë) që i cakton Kuvendi i FGJK-së.

Bordi Disiplinor merr vendime në një panel prej tre anëtarësh.

Artikulli 16.

Bordi disiplinor që zhvillon procedurat është i detyruar të njoftoj shoqatën, klubin, anëtarin ose individin kundër të cilit fillon procedura dhe arsyet për fillimin e procedurës disiplinore. Keto procedura disiplinore duhet të trajtohen urgjentisht.

Artikulli 17.

Bordi disiplinor është kompetent për kundërvajtjet e kryera në garat (aktivitete), brenda juridiksionit të FGJK-së (në Kosovë), dhe të gjitha garat jashtë vendit, si dhe kundërvajtjet që dëmtojnë imazhin dhe reputacionin e FGJK-së dhe anëtarëve të saj, si dhe shkeljet tjera të cekura në rregulloret e FGJK-së.

Artikulli 18.

Procedurat disiplinore inicohen në bazë të:

- Raportimit të delegatëve,

- Raportimit të gjyqtarit/ëve,

- Raportimt të personave tjerë përgjegjës në garë ose aktivitet,

- Raportimit të shoqatavë ose organve tjera të FGJK-së,

- Bazuar në aplikimin e nënshkruar të individit dhe anëtarit të FGJK-së,
- Sipas detyrës zyrtare, atëherë kur Bordi Disiplinor njftohet për shkelje të kryer.

Artikulli 19.

Asnjë veprim disiplinor nuk mund të inicohet në bazë të raportimit anonim.

Artikulli 20.

Procedurat disiplinore nuk mund të inicohen nëse aplikimi apo raportimi nuk është parashtruar me kohë.

Afati i fundit për dorëzimin e raportit, ankësës është 30 ditë nga data e shkeljes, Pas këti afati, ankesa nuk pranohet dhe si e tillë cilësohet e skaduar.

Artikulli 21.

Përjashtimisht afati i fundit për paraqitjen e kërkesës është më së shumti 1 vit nga data e veprës nëse vepra ka të bëjë me:

- Gara ndërkombëtare,
- Marrëveshjes për rezultatin e garavë,
- Aktet për të cilat përgjegjësia disiplinore është inicuar nga organet e Federatës Ndërkomëtare të Gjimnastikës (FIG), Gjimnastika Euorpiane (EG), COMEGYM (Lojrat Mesdhetare), dhe Gjimnastika Ballkanike (BG).
- Aktet për të cilat Bordi Ekzekutiv ose Asambleja e FGJK-së konstatojnë se reputacioni i FGJK-së dhe gjimnastikës në Kosovë është dëmtuar serizosht.

Artikulli 22.

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet masave disiplinore, pa u ftuar së pari, të dëgjohet / ipet dëshmia e tij/saj me shkrim ose verbalisht, dhe të jap mendimin e tyre (të mbrojtjes).

Artikulli 23.

Pas fillimit të procedurës, Bordi Disiplinor mund të vendosë të suspendoj vendimin e një shoqate, klubi, apo individi.

Suspendimi zgjatë 30 ditë dhe mund të zgjatet nga Bordi Disiplinor nëse procedura nuk është përfunduar ende, edhe për 30 ditë shtesë.

Nuk ka ankesë kundër vendimit të suspendimit.

Artikulli 24.

Shoqata, Klubi apo individi i suspenduar nuk ka te drejtë të marrë pjesë në vendimmarrje të FGJK-së, dhe nuk mund të marrë pjesë në garat dhe aktivitete e organizauara nga FGJK, dhe as në gara ndërkombëtare.

Artikulli 25.

Bordi Disiplinor mund të vendos të suspendoj çdo person kundër të cilit është kryer një procedim penal, ose ku përsoni/nat në fjalë janë denuar me vendim të prerë nga gjykatat e Republikës së Kosovës, apo edhe ndonje shteti ndërkombëtarë.
Bordi Disiplinor mund të urdhërojë konfiskimin e çdo çmimi ose përfitimi financiar të fituar si rezultat i çdo shkeljeje të Statutit dhe rregulloreve të FGJK-së.
Përveç kësaj, në rast dyshimi për shkelje të statuteve dhe rregulloreve të FGJK-së, Bordi Disiplinor mund të urdhërojë konfiskimin e objekteve ose substancave për nevojat e hetimit, në baza të përkohshme.

Artikulli 26.

Nëse brenda një periudhe prej 60 ditës, Bordi Disiplinor nuk merr vendim, atëherë konsiderohet se shoqata, klubi, individi kundër të cilit/lës zhvillohen procedurat nuk suspendohet më, por kjo nuk nënkupton ndërprerjen e procedurave disiplinore ose lirimin e përgjegjesisë.

Nëse Bordi Disiplinor nuk merr vendim disiplinore gjatë muajve nga paraqitja e kërkesës, atëherë statusi i kufizimeve është shkelur.

Artikulli 27.

Vendimi i Bordi Disiplinor bëhet me shumicën e votave të Këshillit, gjatë mbledhjeve përcaktohet një anëtar që i shkruan emrat e anëtarëve prezent, dhe dëshmin e tyre e japin me nënshkrimin e tyre.

Vendimin për masat displinore nënshkruhen nga Kryetari i Bordit Disiplinor, gjegjësisht anëtari që në mungesë të Kryetarit, kryen detyrat e Kryesuesit në seancën në të cilën është marrë vendimi për masën disiplinore.

Artikulli 28.

Secili vendim nga Bordi Disiplinor duhet të përfshijë:

- Numrin e anëtarëve të bordit të pranishëm,
- Shpalljen e masave disiplinore,
- Shpjegimin,
- Ligjin apo rregullorën.

Artikulli 29.

Vendimi i Bordit Disiplinor duhet ti dorzohet personalisht ose me anë të postës së regjistruar, në të njëjtën kohë një kopje e vendimit duhet ti dorëzohet shoqatës, klubit, ose organit ku personi/ja është e regjistruar apo vepron.

Nëse vendimi refuzohet të pranohet nga shoqata, klubi, organi apo personi/ja, atëherë konsiderohet që vendimi i është dorëzuar.

IV. TË DREJTË NË ANKESË

Artikulli 30.

Palët do të kenë të drejtën të përfaqësohen nga një përfaqësues ligjor dhe/ose përfaqësues tjetër përkatës sipas zgjedhjes së tyre me paraqitjen e një përfaqësuesi me shkrim.
Çdo i mitur nën 18 vjeç do të përfaqësohet, nga prindi, kujdestari, etj.

Ankesa në vendimin e Bordit Disiplinor në shkallë të parë i paraqitet Bordit Ekzekutiv të FGJK-së, brenda 8 ditëve, nga data e dorëzimit të vendimit.

Aneksa e parashtruar jashtë afatit do të refuzohet dhe cilësohet si e pabazuar.

Ankesa e depozituar duhet të përmbanë ekzekutimin e vendimit të kontestuar,

Artikulli 31.

Kundër vendimit të Bordit Disiplinor mund të ankohen:

- Personi/ja, respektivisht shoqata, klubi ndaj të cilit i është drejtuar masa disiplinore,
- Aplikuesi,
- Një organ, ose anëtarë i cili është objekt i masave disiplinore,

Artikulli 32.

Kur të vendoset për ankesë kundër vendimit të Bordit Disiplinor, Bordi Ekzekutiv, si një trup, në shkallën e dytë mund të marrë vendime të cekura më poshtë:

- Ta hedh poshtë ankesën si të pabazuar,
- Refuzojë ankesën, dhe ta konfirmoj vendimin e Bordit Disiplinor,
- Ankesa të pranohet, vendimi dhe lënda të kthehet prap në Bordi Disiplinor për rishqyrtim dhe vendim-marrje.
- Ankesa të pranohet, dhe të ndryshojë vendimin e Bordit Disiplinor,

Vendimi i Bordit Ekzekutiv është ekzekutues (përfundimtar).

Artikulli 33.

Vendimi i Bordit Disiplinor bëhet i formës së prerë atëherë kur:

- Skadon afati për ankesë për vendimin e Bordit Disiplinor,
- Kur vendimi miratohet nga Bordi Ekzekutiv në shkallën e dytë,

Vendimi i dërgohet të gjitha palëve të interesuara.

Masa disiplinore fillon nga data në të cilën vendimi është i prerë, ndërsa nga koha deri sa ishte/është në suspendim, llogaritet kohëzgjatja e masave disiplinore.

Artikulli 34.

Kundër vendimeve përfundimtare të Bordit Ekzekutiv, mund të bëhet kërkesë për mbrojtje në Organin e Arbitrazhit Sportiv të Komitetit Olimpik të Kosovës, ku kërkesa duhet të paraqitet në përputhje me rregullat e Arbitrazhit të Komitetit Olimpik të Kosovës.

FGJK është e detyruar të pranojë pjesëmarrjën në procedurën e Arbitrazhit dhe të pranojë vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet e bëra.

V. REDUKTIMI I JASHTËZAKONSHËM I DENIMIT

Artikulli 35.

Në kërkesën (ankesën) e shkelësit, Bordi Ekzekutiv mund të liroj nga denimi, ose dënimin ta zbusë (lehtësoj), nëse ka rrethana të tilla që justifikojnë miratimin e një vendimi të tillë.

Sa i përket vendimmarrjes në kuptim të paragrafit të lartë cekur, mendimi i Bordit Disiplinor gjithmonë do të kërkohet.

Kërkesa (ankesa) për lirim të jashtëzakonshëm ose lehtësim të masave disiplinore mund të bëhet pas një periudhe prej tre muajsh nga data e vendimit përfundimtarë.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Artikulli 36.

Denimet për shkelje të akteve të shoqatave, klubeve, organeve të gjimnastikës në rajone dhe gjimnastikës në Prishtinë, nuk mund të jënë më të buta se denimet e parashikuara me këtë rregullore.

Artikulli 37.

Rregullorja është miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, me datë 21/05/2026

Kryetari i FGJK-së:

Shkumbin Maqastena

Sekretari i FGJK-së:

Amir Tahiraga